

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE DURRES

Nr. 622 Rep

Nr. 123 Kol.

PULLE TAKSE



KONTRATE SHITBLERJE
"Kuota Sh.p.k.-je"

Ne Durres, sot me daten 15 Shkurt 2006 (dymije e gjashte), dite e Merkure, para meje Noterit publik Lindita LULA, anetar i Dhomes se Noterise Durres, u paraqiten personalisht shtetasit pale per lidhjen e kesaj kontrate, me keto cilesi ligjore dhe identitete :

1. **Pale shitesë:** Ortakja e Shoqerise Tregtare "Johaniteri" Sh.p.k., Enkeleda Rama, e bija e Selamit, e datlindjes 15.10.1970, banuese ne Lagjen Popullore Shijak/Durres identitetin e se ciles e verifikova sipas ligjes.
2. **Pala Blerese:** Shtetesja Evelina Reka, e bija e Hysniut dhe e Quetheres, e datelindjes 22.06.1967, lindur dhe banuese ne Shijak/Durres, lagja Popullore, identitetin e se ciles e verifikova me ane te Certifikates se lindjes Nr.20-7, viti 1974, leshuar me 06.02.2006.

Shtetaset jane madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar

Bazat Juridike te Kontrates

NENET 6,149,705-708,710,711,714, 719-723; 730 te KODIT CIVIL

Pas njohjes me permbajtjen e dispozitaave juridike civile te mesiperme, me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, te sinqerte dhe me irkuptim te ndersjellte, palet lidhin kete kontrate, sipas ketyre deklarimeve :

Une Pala Shitesë jam njera nga Ortaket Themeluese te Shoqerise Tregtare "Johaniteri" Sh.p.k., e regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane me Nr.33927 Vendimi, date 07.09.2005, dhe disponoj 33% te kuotave te kapitalit themelor te kesaj shoqerise, me vlere 33.000 leke, ku nje kuote eshte e barabarte me 1.000 leke.

Te gjithë kete vlere kuotash, qe perben nje pjese te kapitalit themelor te shoqerise, ne masen 33%, me vlere 33.000 leke, **une ia shes jashte shoqerise shtetases Evelina Reka**, me te njejten vlere nominale kuotash, me koeficientin 1.000 leke/1 Kuote qe arrin shumen 33.000 leke, pagese e cila i eshte kryer ne Cash per te gjithë vleren e kuotave.

Pala Blerese deklarom se eshte plotesisht dakort qe te bleje teresisht kuotat e kapitalit themeltar prej 33%, me vlere 33.000 leke, qe disponon shitesja ne Shoqerine Tregtare "Johaniteri" Sh.p.k. dhe **se ia ka parapaguar** kete shume ne Cash pales shitesë jashte kesaj Zyre, fakt ky qe konfirmohet me deklarim pohues para meje Noterit dhe nga vete pala shitesë.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, **Pala Shitesë humbet** plotesisht pronesine mbi kontributin e dhene per formimin e kapitalit themelor te Shoqerise Tregtare "Johaniteri" Sh.p.k. **si dhe qenien e metejshme si Ortake themeluese** e kesaj Shoqerise. **Pronesia mbi keto kuota** te kapitalit themelor te Shoqerise "Johaniteri" i kalon e plote shtetases **Evelina Reka**, e cila behet zoteruese e tyre, si dhe e drejta per tu bere Ortake themeluese e kesaj Shoqerise Tregtare.

Gjithashtu, palet me mirekuptim te ndersjellte mes tyre, pranojne se qe nga momenti i nenshkrimit te kesaj kontrate Pala Shitesë humbet te drejten e perfitimit si dhe mbartjen e detyrimeve nga aktiviteti tregtar i kesaj shoqerise dhe se qe nga ky moment e ne te ardhmen keto te drejta e detyrime i kalojne Blereses Evelina Reka.

Kontrata hartohet ne 4 kopje origjinale, te gjitha te barasvlefeshme me njera tjetren dhe pasi lexohet me ze, nenshkruhet nga palet ne pranine time, une Noteri vertetoj.....

SHITESJA
Enkeleda Rama

Enkeleda Rama
[Signature]

NOTER

LINDITA LULA

[Signature]

BLERESJA
Evelina Reka

EVELINA REKA
[Signature]